



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prudato Received/Deliverty	08.02.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	551/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.410/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.410/2020 të datës 10.12.2020 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë rruga “Këndi i rrugëve Bill Clinton dhe Dëshmorët e kombit”, ndërtesa e Administratës Tatimore të Kosovës , kundër Njoftimit të datës 19.11.2020 të Drejtorit të teknologjisë informative, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.410/2020 e datës 10.12.2020, e parashtruar nga ankuesi _____

Arsyetim

Ankuesi _____ i punësuar ne pozitën “Administrator për operacione dhe përkrahje” në Departamentin e Teknologjisë Informative, Divizioni-Operacione dhe përkrahje, në Administratën Tatimore të Kosovës, me datën 10.12.2020 ka ushtruar ankesë me numër të protokollit 3078/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore: për mos shqyrtim të kërkesës për avancim në pozitën e Administratorit të Sistemit nga ana e Udhëheqësit të tij, për trajtim të pabarabartë , të pa drejtë të kërkesës së tij të datës 28.05.2019 për ri caktim ne këtë pozite si dhe kundër caktimit të Shkëlqim Selmanit ne pozitën “Administrator” ne Divizionin e Sistemeve ne Administratën Tatimore te Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 24.12.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Me datën 13.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 10.12.2020 me Nr.Prot:3078/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 25.11.2020; E-maili zyrtar i datës 19.11.2020; E-maili zyrtar i datës 16.11.2020; E-maili zyrtar i datës 16.11.2020; E-maili zyrtar i datës 10.11.2020; Kërkesë për ri caktim/gradim e datës 28.05.2019; E-maili zyrtar i datës 13.02.2020; E-maili zyrtar i datës 28.05.2019; E-maili zyrtar i datës 19.11.2020; Vendim i datës 23.01.2018 për njohje të gradës master për ankuesin; Kërkesa për përgjigje në ankesë 24.12.2020; Përgjigja në ankesë e datës 13.01.2021; Akt emërim i ankuesit me numër Nr.Prot.02/928/11 i datës 01.02.2013; Lista e pagave për periudhën 01.11.2020 deri 30.11.2020; Lista e pagave për periudhën 01.12.2020 deri 31.12.2020; E-maili zyrtar i datës 11.02.2020; E-maili zyrtar i datës 17.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e **palejuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk është përzgjedhur në pozitën "Administrator i sistemit" në Divizionin e Administrimit të Sistemit nga Drejtori i Teknologjisë Informative, në Administratën Tatimore të Kosovës përmes e-mailit të datës 10.11.2020, mirëpo është caktuar nëpunësi civil

me detyra dhe përgjegjësi shtesë, në këtë pozitë, ka konstatuar se: ankuesit me këtë veprim juridik nga ana e Drejtorit të Teknologjisë Informative nuk i është cenuar asnjë e drejtë, sepse në bazë të dëshmive (listës së pagave për muajt nëntor-dhjetor të vitit 2020) të ofruara nga organi i punësimit nuk është ndërmarr asnjë veprim juridik që ka cenuar marrëdhënien e tij të punës, apo është dëmtuar me pagë sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publike dhe rregulloreve për zbatimin e këtij ligji.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrone vetëm nëpunësi civil, të cilëve iu janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji siç përcaktohet me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publike, përcaktohet se: **"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative"**, e që në rastin konkret, ankuesit në këtë kuptim me asnjë veprim nuk i është cenuar asnjë e drejtë në marrëdhënien e tij të punës, kështu që në kuptim të nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit është e palejuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi qe ka shqyrtuar dhe analizuar faktet dhe provat relevante sa i përket ankesës së ankuesit, nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit sepse ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse në rastin konkret nuk i është shkelur ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës, nga veprimet Drejtorit të Teknologjisë Informative, në Administratën Tatimore të Kosovës, sa i përket caktimit të nëpunësit tjetër me detyra dhe përgjegjësi tjera në pozitën „ Administrator i sistemit “, në Divizionin e Administrimit të Sistemit të Administratës Tatimore të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.410/2020

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.